



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 060/01-74821

Pejë, datë: 29 shtator 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i –VII - i rregullt i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **29 shtator 2025** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z.Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 32 anëtarë prezent. Po ashtu kryesuesi i kuvendit në emer të anëtarëve të kuvendit shprehi ngushëllime familjarve të viktimave për të dy rastet e fundit që kanë ndodhur në qytetin tonë.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, me 32 vota pro, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.07.2025.
3. Rishqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035, sipas kërkesës së MMPHI, me nr. prot. 5809/2/25, dt. 14.08.2025.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Pejës 2026-2028.
5. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft Plani të Punës së Kuvendit të Komunës së

Pejës – 2026.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2026.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2025.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2025.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSBB-së për vitin 2025.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i komunikatës mbështetëse për deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë.
11. Shqyrtimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.
12. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
13. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z.Granit Kelmendi, znj.Fjollë Dembogaj, z.Rrustem Berisha.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.07.2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 25 votë pro, 6 votë të përmbajtur, 1 votë kundër miratohet procesverbali i seancës të datës 29.07.2025.

4.Rishqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035, sipas kërkesës së MMPHI, me nr. prot. 5809/2/25, dt. 14.08.2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kemi marr sugjerim nga ministria për plotësim/ndryshimin e planit të cilin e kemi miratuar në senacën e kaluar, pastaj është korigjuar dhe e kemi sjellë përsëri në kuvend me marrë vendimin për miratimin e planit!

Nga të gjithë anëtarët prezent 24 votë pro, 5 anëtar kundër, 1 votë e përmbajtur dhe dy anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Pejës 2026-2028.

Znj.Diellza Berisha: meqenëse sot po zhvillojmë senacën e fundit para zgjedhjeve lokale 12 tetorit, me lejoni të shpreh mirënjohje për kontributin e secilit prej jush gjithashtu të ju uroj suksese të gjithë atyre që janë pjesë e gares për asamble komunale. Sot para jush po paraqes projekt buxhetin e komunës së Pejës për vitin 2026, si një dokument strategjik që përcakton drejtimin zhvillimor për vitin e ardhshëm. Ky buxhet është rezultat i një procesi të gjatë të planifikimit i cili ka kaluar nëpër disa faza. Faza e parë filloi me caktimin e grupit punues nga ana e kryetarit të komunës. Duke qenë pjesë e atij grupi punues, më lejoni t'ju informoj që si grup punes kemi mbajtur takime të vazhdueshme me ekspertë nga Demosi me qëllim të realizimit të një procesi sa më të mirë të planifikimit. Së bashku me kryetarin e komunes kemi zhvilluar takime publike me qytetarët në të gjitha zonat urbane dhe rurale të komunës së Pejës, për të dëgjuar drejtëpërdrejtë prioritetet dhe shqetësimet e qytetarëve. Në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive kemi identifikuar nevojat specifike sektoriale dhe i kemi radhitur projektet sipas mundësive buxhetore. Si drejtoreshë për buxhet dhe financa garantoj që hartimi i këtij buxheti është bërë në përputhje me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe bazuar në udhëzuesin e lëshuar nga Ministria e Financave. Në pika të shkurta po e bëj një prezentim të struktures së buxhetit të komunës së Pejës për vitin 2026. Në total për vitin 2026 komuna e Pejës ka një buxhet prej 41,953,839.00 euro. Ky buxhet është i ndarë në disa kategori. Pjesën më të madhe e ka kategoria paga dhe medijtje 21,321,772.00 euro, shpenzime komunale 1,107,240.00 euro, subvencione dhe transfere 1,360,000.00 euro dhe shpenzime kapitale 12,712,887.00 euro. Ftoj të gjithë asambleistët pa dallime politike të bëjnë mbështetjen e këtij dokumenti të rëndësishëm duke dëshmuar edhe një herë përkushtimin e tyre për qytetarët e komunës së Pejës.

Z.Naim Bytyqi: drejtoresha na ftoj pa dallim partie politike të gjithë ta votojmë këtë buxhet 2026-2028. Mirëpo unë i radhita disa arsye pse ne e kemi të vështirë t'i përgjigjemi kërkesës së drejtoreshës. Për fillim projektet në vazhdimësi po gjejmë projekte të përsëritura. Unë prej se jam asambleistë para katër viteve i kemi gjetur projektet tek muri, te bistrica atje dhe hala në 2026-en dhe ende jemi duke nda mjete për atë murë. Andaj mendoj që ky projekt në tërësi duhet me rishiku edhe njëherë. Temë tjetër është vetëm një cent të ishin nda për banorët e lagjes "Asllan Çeshme" për dëmtimet nga vërshimet, ndoshta ishim bind edhe na me u përgjigjë pozitivishtë votimit të këtij buxheti. Si ka mundësi asnjë cent mos të ndahet për lagjen më të madhe të komunës së Pejës siç është lagja Dardania! Përveq renovimit të QMF-së, asnjë cent për atë lagjen kur e dim që trotualet në lagjen Dardani janë rrënuar të gjitha. Rrugët janë në gjendje kaotike siç është rruga kryesore "Ardian Krasniqi" po ashtu dhe rrugë të tjera. Po ashtu ndërtimi i urrës Leshan që në senacë e kaluar kam kërkuar të futet në projektet për vitin 2026 edhe ky projekt është shty, edhe kjo ma rrit arsyen për mos me votu këtë buxhet. Ndërtimi i sheshit "Shkelzen Haradinaj" është duke u shtyer nga viti në vitë edhe kjo është një arsye që nuk mundemi me u përgjigjë pozitivishtë votimit të buxhetit. Vetëm 500 mijë euro të ndara për bujqësi, e unë që merna me bujq e kam shumë zorë me votu këtë buxhet ku janë diskriminu komplet bujqt dhe fermeret. Ndërsa mjetet për dreka dhe darka ishin të rregulluara dhe të sistemuar mirë. Andaj të dashur koleg po mundohna me u kon shumë i singertë, që e kemi të

pamundur me ju përgjigjë pozitivishtë kërkesës së drejtoreshës pasi që ky buxhet nuk i përfaqëson interesat, nevojat,dhe kërkesat e qytetarëve.

Z.Feriz Gashi: kam një pyetje drejtpërdrejtë me kryetarin po e shoh 150 mijë euro për ujësjellësin e Lugut të Baranit, a ka me u përfundu kjo punë? A kanë me pas ujë banorët e Lugut të Baranit 2026? A ka mundësi mem tregu kryetar për këto 12 vjet sa para i ke varros në tokë për me i furnizu banorët e Lugut të Baranit me ujë, e nuk i ki furnizu? Prap po pyes a ka me u përfundu dhe a ka me u mbyllë kjo punë? Sepse sa e ke dekoruar po i shoh dritat në Lumbardh po mendoj që furnizimi i banorëve të Lugut të Baranit me ujë të pijshëm është jetike, kurse kjo është lluks.

Z.Drin Veselaj: ralishtë kryetari e ka marr mundin me bo këtë buxhet , por nuk ka pas nevoj me mu mundu shumë sepse ky buxhet ka me u rishiku prej kryetarit të ardhshëm. Çka më ka bër përshtypje që kryetari në çdo debat, në çdo takim ka fol për shkollat dhe palestrat që i ka ndërtu. Ndërsa në buxhetin që sot e kemi përpara prap janë të planifikuara mjete. Për shembull për ndërtimin e palestrës në Zahaq 26 mijë euro i keni përruruar dhe prap e keni bërë ndërtimin e palestres në Zahaq! Gjithashtu ndërtimi i gjimnazit ju thatë që i keni ndërtu shkollat dhe nuk po di për qfarë gjimnazi po bëhet fjalë, a e keni fjalën për ndonje të ri a po e keni fjalën për atë që e keni filluar tash që 10 vjet? Gjitha këto planifikime që ju i keni bo në këtë buxhet sigurishtë që janë pasojë e keqmenaxhimit të viteve të kaluara ku s'kemi arritur asnjë projekt me qu deri në fund dhe me kry qysh duhet. Unë mendoj që ky buxhet ky planifikim është një tentim për me vazhdu me i mashtru qytetarët për shkak se shumicën e mjeteve i keni planifikuara për vitin 2027 dhe 2028. Na po e shohim që do punë që nuk janë kry që katër vjet , keni filluar 100 punë me i kry, dhe asnjë nuk jeni duke e përfunduar, vetem keni fillu që qytetarët me i provu edhe njëhere me j'a marrë votën. Shpresoj shumë që asambleja e ardhshme edhe kryetari i ardhshëm ka me qenë më vigjilent në këtë drejtim, ka me qenë më i përgjegjshëm, më trasnaprent dhe ka me i kry nese është nevoja edhe më pak punë, mirëpo me i kry ashtu qysh duhet.

Z.Nezir Jahmurataj: unë si pjesë e këtyre katër viteve që nga fillimi ju kam drejtuar kryetarit dhe drejtorisë, që ne si përfaqësues të këtyre 100 mijë qytetarëve e kemi obligim që buxhetin aq sa e kemi dhe sa na krijojnë mundësitë ta ndajmë në mënyrën njëzore për të gjithë komunitetin dhe të gjitha bashkësitë lokale. Për këto katër vite nuk e kam parë, gjithmonë kam kërku për kokë të banorit dhe le të jenë të gjithë qytetarët të barabartë. Unë personalisht kam kërkesa për komunitetin tim në Lubeniq dhe në Raushiq. Dhe me kanë pengu dy rrugë njëra që e lidh Raushiqin me Loxhen, dhe me rrugën e Dardanisë që e lidh me hy në qytet është tmerësishtë e ngarkuar. Unë ju uroj të gjith gjithëve suksese dhe shpresoj që në këtë asamble dhe në këtë kuvend të vin njerëzit e merituar.

Znj. Vjendita Kelmendi Gërgoci: edhe pse jemi në piken e buxhetit deshta me mar fjalën e me ju falenderu që në seancat e kaluara kam kërkuar të punësohen logopedë në mënyrë që fëmijet që kanë ngecje në të folur ta marrin shërbimin e duhur. Jam shumë e lumtur që iniciativa ime ka sjellë një rrezultat kaq të rëndësishëm dhe në spitalin e Pejës është punësuar një logoped.

Z.Berat Ganiqi: në lidhje me buxhetin 2026-2028 i kam vetem dy pyetje, a mundeni me më tregu kjo rruga Dobërdol-Poqestë qka përshkruan dhe rruga e Dushkajes cilen rrugë e përshkruan?

Z.Islam Husaj: unë ju përgëzoj ju grupin punues, kryetarin, dhe gjithë drejtorët për hartimin e këtij buxheti që unë mendoj që është një buxhet shumë mirë i hartuar dhe ka projekte zhvillimore për nevojat e qytetarëve. Ne jemi të vetdijshëm se projektet të cilat janë shumëvjeçare, ato për çdo vjet duhet të përsëriten dhe duhet të kërkohet buxhet për realizimin e tyre. Unë ju përgëzoj sepse janë 12,712.887.00 euro të parapara për zhvillim për projektet kapitale. Gjatë shikimit të dokumentit kam parë disa gabime teknike jo përmabjtësore të cilat i kisha përmend. Fjala është për investimet kapitale rindërtimi i murit, muri po ndërtohet në vazhdimësi nuk është që tash po ndërtohet. Edhe tek rrethojat e varrezave është mirë që e keni cek se cilat varreza duhet të rrethohen për atë dokumentin përfundimtar. Po ashtu janë do projekte mjaftë të mira që i keni parapa për interesin e qytetarëve, rregullimin e infrastuktures publike në zonat industriale Bestovikë, Sferkë, Zahaq, Lugë të Baranit. Mandej ndërtimet e kanalizimeve, megjithëse pak mjete janë ndar për kanalizime. E kam një kërkesë tek bujqësia janë disa projekte të parapara por e kisha shtu edhe kanalin e ujitjes për Millovancë, Poqestë në ato fshtrat atje janë diku 160 hektar që ujiten dhe mungon ai kanal. Në diskutimin publik që e kemi mbajtur për hartimin e buxhetit, ne kemi dhënë disa propozime, por në raportin të cilin e keni dërguar nuk janë evidentuara asnjë nga ato propozime. Kështu që është i mangët ai raport i diskutimit publik edhe ai duhet të plotësohet. Në atë diskutim kam kërkuar që të ndahen mjete më shumë për zhvillim ekonomik sepse janë vetem dy projekte të parapara për vitin e ardhshëm. Po ashtu tek drejtorja e kultures është dasht me i shti në subvencion edhe ditet letrare të Azem Shkrelit, Lojrat Tradicionale Rugova. Krejt në fund e kemi një problem me zerimin e kuvendit dhe nuk e pash që është parapa diku me u rregullu ndoshta po ndërtohet komplet salla, me zërim dhe me të gjitha.

Z.Rajan Arapi: edhe ne si grup e kemi analizura buxhetin e planifikuar. Mendoj që është një shpërndarje relativisht e mirë që është bërë, një dizajnim i mirë edhe pse ka disa mangësi, disa gjëra të cilat realisht është dashur apo është mirë që të korigjohen. Përpara çfarë kisha potencuara meqenëse çdo që bëhet, çdo gjë që planifikohet e lidhi pak a shumë me planin zhvillimor komunal sepse është dokumenti kryesor i komunës dhe e shoh që projektet që janë planifikuar nuk janë harmoni shumica prej tyre në planin zhvillimor komunal. Në fund e di që ky plan zhvillimor komunal zbatueshmërinë nuk ka me pas të mirë qashtu qysh e kemi synuar kur e kemi përpiluar, bashkë me kryetarin, bashkë me digasterët, dhe me gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në këtë plan zhvillimor. Tjetra ato çfarë janë paraqitur këtë buxhet prap po them që janë të dizajnuara mirë. Por ajo se çfarë me pengoi është shtyrja e ashensorëve për vitin e ardhshëm edhe buxheti që mendoj që është i vogël prej 50.000 euro për këtë ashensor. Po ashtu që katër vite kam kërkuar që të finalizohet apo të fillohet nga e para mbuloja tek shtëpia e mallrave. Drejtori ka dal bashkë me mua, e ka dërguara ekipin me matë dhe ato matje ku me ditë kanë mbetur diku në sirtarët e drejtorisë për punë komunale dhe shërbime publike. Ky projekt ka mbet qysh ka mbet, është bër edhe pranimi teknik i tij. Mirëpo prapë po them me keqardhje diqka që kemi nisur me një ide shumë të mirë, ka mbetur një projekt i shëmtuar që është dashur të

planifikohet edhe të finalizohet sepse është në zemër të qytetit të komunës së Pejës. Ne si grup kemi vendosur që për hirë të qytetarëve, për hirë të projekteve që janë paraparë dhe për mirëqenien e të gjithëve ta votojmë këtë buxhet.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: një përgjigje Rajan, janë ndar 50.000 euro nese kalon një projekte në të cilin ne participojmë me donatorin që ka me i rregullu këto punë. Nese na heken sanksionet edhe hymë në atë procedurë atëhere ne kemi edhe participim tjetër rritje të buxhetit dhe e rrisim. Ky buxhet është nda me qeto mundësi që i kena siç po e sheh janë nda 800.000 mijë euro për solare, 1 milionë euro për deponin në Sferkë. Domethënë është planifiku buxheti për me i relalizu dhe me ec përpara.

Znj.Hidajete Nikçi: është shqetësim kur dëgjoj drejtorin e bujqësisë që Lugu i Baranit nuk ka nevoj për ujin e pijes.! Ndoshta drejtori ka hapur një bunar, por ne të tjerët që jetojmë aty kemi nevoj dhe uji është jetik. Po ashtu dua ta pyes kryetarin e pash në planifikim të buxhetit që ka ndarë për asfaltimin e rrugëve. A do të jetë në planifikim asfaltimi i rruges në bjeshkën në Shtupeqin e Madh, që ka mbet për shkak të një shkëmbi ajo pjesë e rrugës e pa asfaltuar, po pyes konkretisht a do të asfalttohet?

Znj.Eleonora Bala: sa i perket ndërtimit të qendrave të mjeksisë familjare në parlamentin e Kosovës është diskutuar që ndërtesa të reja mos të ketë më, sepse po ndërtohen shumë ndërtesa të reja. Shumica prej tyre edhe po dështojnë siç është rasti me QMF3 në Karagaq, e cila sot është në gjendje të mjerushme. Arsyeja se pse mos të ndërtohet është se të investohet në faktorin njeri sespe është lënë shumë anash. Mjekët familjarë punojnë me një stetoskop, me një tensiometër, mungon edhe aparatura, dhe ajo aparatur që është shumica nuk din ta përdorin. Sepse drejtorati për shëndetësi nuk i ka dërgu mjekët në trajnime në menyrë që specialistat e mjeksisë familjare të kenë shkathtësi të mëdha.

Z.Labinot Panxha: ne këtu kemi folur për katër vite me radhë, jemi mundu me bashkëpunu, jemi mundu me kritiku e me dhënë vërejtje e shumë çka tjetër. Besoj shumë që kemi mujt sadopak diqka me bo mirë në këtë temë. Drejtoresha e ndëruara na kërkoj me mbështet na si asamble, por nuk na ka kërku kurrë me ardhë dhe bashkarishtë me bo buxhetin edhe pozita edhe opozita. Edhe koleget e mi nga opozita mendoj që duhet me kuptu që kjo është staregjia për hartimin e buxhetit është strategji e LDK-së. Sigurishtë që neve nuk na pëlqen, se sikur te na kish pelqy neve ne kishim qenë bashkë me juve. I pelqen PDK-së sespe PDK në vend se me pas mbështetje për kandidaten e vet , kërkojnë mbështetje për Gazin. A është nda ky buxhet në mënyrë të barabartë për krejtë qytetarët? Sigurishtë që nuk është nda. A e zhvillon bujqësinë ky buxhet? Nuk e zhvillon sepse janë nda pak pare. Po shkojmë tek Lugu i Baranit edhe drejtorinë e kemi nga ajo anë po e shohim buxhetin dhe po i shohim kërkesat e qytetarëve atje të cilat janë shumë të mëdhaja, ndërsa në buxhet nuk janë të përfshira. Unë, nuk po du me fol mo për ujësjellësin e Lugut të Baranit sepse e kanë bo shumë politik dhe po dojnë me marrë vota në atë pjesë, por janë nda 150.000 euro dhe nuk e di a janë të mjaftushme dhe nuk e di a ka me u përfundu ai projekt me ato pak mjete që janë nda. Por e di një gjë që këtë hartim të buxhetit që e keni sjellë këtu nuk

mendoj që ka me u implementu në tërësi edhe nese ju jeni në pushtet, por as nga ata që vijnë. Ndoshta kemi me qenë na dhe qysh tha edhe kolegu që duhet me rishiku mirë, me shtu diqka se me mungu se besoj që kemi me mungu diqka! E gjitha kjo ke që me i tregu drejtoreshës dhe kryetarit që nuk duhet me kërku mbështjetjen e opozites, përderisa ju nuk e ftoni bashkarishtë me e implementu buxhetin ashtu qysh e bëjnë edhe komunat e tjera.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 12 kundër, miratohet Buxheti i Komunës së Pejës 2026-2028.

6.Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft Plani të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kemi formuar komisionin, kemi punuar me atë komision për planin e punës së kuvendit për vitin 2026. Kemi mbajtur takime gjithashtu edhe në diskutim publik me qytetarët. Tani e kemi draftin final për planin e punës së kuvendit për vitin 2026.

Nga të gjithë anëtarët prezent 19 votë pro, kundër nuk ka, 4 votë të përmbajtur, dhe 12 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2026.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: gjithashtu është parapa të jenë brenda kornizave të caktojme datat të cilat duhet të mbahet kuvendet e rregullta dhe takimet e komitetit për politikë dhe financa. Janë data që mund të ndryshohen brenda mujit, por kryesisht në fund të muajit mbahet seanca e rregulltë dhe në mesin e muajit KPF.

Nga të gjithë anëtarët prezent 21 votë pro, kundër nuk ka, të përmbajtur nuk ka, dhe 11 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet Kalendar i takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2026.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është propozim nga drejtoria dhe kryetari i komunës me marrë vendim për kompensimin e tyre.

Nga të gjithë anëtarët prezent 18 votë pro, 4 votë kundër, të përmbajtur nuk ka, dhe 10 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2025.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurbogaj: dhe për komitete tjera është fjala po e plotësoj. Edhe vitin e kaluar edhe këtë vitë e kemi sjellë si propozim në kuvend të miratohet kompenzimin për komitetet që operojnë në kuvend dhe janë trupa që e mbështesin kuvendin dhe japin kontributin e tyre.

Nga të gjithë anëtarët prezent 18 votë pro, kundër nuk , të përmbajtur nuk ka , dhe 14 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2025.

10.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSBB-së për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e dini rolin e KKSBB-së dhe takimet që i mbajnë gjatë vitit për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe problemet që janë për diskutim në këto takime.

Nga të gjithë anëtarët prezent 19 votë pro, kundër nuk , të përmbajtur nuk ka , dhe 14 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSBB-së për vitin 2025.

11.Shqyrtimi dhe miratimi i komunikatës mbështetëse për deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë.

Kryesusi Rexhep Kurbogaj: ka qenë si propozim nga anëtarët e kuvendit dhe nga grupi i grave asambleiste gjithashtu dhe nga dr.Islam Husaj, ku e kemi pasur një mbështetje nga OSBE-ja dhe zyrtarëve që i kemi prezent këtu! Në vazhdim kryesusi lexoj deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë e cila është e bashkangjitur në material.

Z.Islam Husaj: unë ju falenderoj juve, kryeatrin, grupin e grave dhe të gjithë ata që e kanë përkrahë këtë iniciativë dhe kërkesën time, që e kam bërë në seancën e kaluar që ta kemi këtë pikë në rend dite. Gjithashtu falenderoj bashkëpunim me OSBE-në të cilët na ka ndihmuar në krejt këtë rrugë që e kemi bërë dhe shpresoj dhe besoj që me aprovimin e kësaj deklarate ne do të kalojmë prej fjalëve në vepra. Dhe do t'i respektojmë të gjitha ato të drejta me gjitha konventat që ju takojnë. Ne si kuvend e mbështesim këtë përpjekje për luftimin e dhunës ndaj grave si në jetën publike, ashtu edhe në atë politike.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet deklarata mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë.

12.Shqyrtimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.

Z.Labinot Panxha: unë e kam një pyetje për drejtorin a jeni përgatitë për me hy në dimër, që ata nxënësit me pas ngrohje në shkolle? A ka material shpenzues dhe a ka me pas nevoj me dal nëpër media që kjo shkolle apo ajo shkolle nuk ka ngrohje?

Znj.Hidajete Nikçi: së pari e përgëzoj drejtorin për këtë raport një faqe. Kisha mu ndal tek plotësimi i vendeve të reja të punës. Unë e kuptoj që tash është fushatë zgjedhore, mirëpo nuk mundem me kuptu se si është bërë plotësimi i vendeve të punës pa kritere. Kemi raste kur ka aplikuar në konkurs, ka shku kur e kanë thirrë për intervistë, kur ka shku se ka gjetur veten në listë, pastaj ka hyrë në test, e ka kalur testin dhe nuk është punësuar në vendin adekuat. Pastaj janë thirrë prapa pasi që kanë filluar të punojnë mësimdhënësit, prap është rikthyer testimi i tyre. Mandej është bërë ndarja e vendeve diku tjetër. Mirë kishte me qenë që gjithë këta student që kanë aplikuar në konkurs për këto vende është mirë që të merret ai i cili është më i përafërmi, jo të merret dikush i cili nuk është student i atij profili. Qoftë me mesatare të lartë, qoftë edhe me tre provime pa diplomu. Po ashtu shohim çështjen e vendeve të punës për matematikë edhe për fizikë. Ne e dimë që kemi probleme këtu. A ndaj nuk duhet të pritët deri të kalojë një muaj dhe të mos plotësohen këto vende.

Z.Drin Veselaj: unë kam një pyetje për drejtorin me fillimin e vitit shkollor kanë filluar edhe këshillat e prindërve me i mbajt takimet e tyre ashtu siq janë në rregullore. Mirëpo si pjesë e këtyre takimeve prindërit kanë vendos me i kërku mjete të holla prej nxënësve. Unë e kam parë një prononcim të drejtorit që ka thënë që komuna ka mjete të mjafteshme dhe nuk ka nevoj të grumbullohen mjete nga prindërit. Ndërsa në anën tjetër aty ku unë jam prind i dy fëmijëve në një shkollë, ne e dim që aty nuk ka pasur ndonjë ndihmë nga komuna ose ndonjë kujdes të veçantë në atë shkollë. Pra unë mendoj që sa jeni drejtor kishte me qenë mirë me zgjedhë këtë çështje sepse ju po deklaroni publikisht që ka mjete sa keni nevoj, ndërsa Këshilli i prindërve që edhe unë jam pjesë i kërkojmë mjete prej prindërve.

Znj.Hidajete Krasniqi: sot nga drejtori i arsimit e pranova një raport për të gjeturat gjatë vizitave sistematike. Mendoj që për këto 4 vite i kam kërkuar që këto vizita të fillojnë edhe po shihet se si rezultat ka pasur shumë ndikim pozitiv. Janë realizuar në 16 shkolla dhe vlen të theksohet se prap Lugu i Baranit nuk ka qenë prioritet as për këto vizita sistematike. Në këto 16 shkolla që janë kry nuk është parapa që edhe shkolla e Lugut të Baranit dhe e Gillogjanin të jenë të përfshira në këto vizita. A është e parapame për vitin e ardhshëm dhe a do të vazhdojnë këto vizita edhe pse pas 25 viteve kjo është hera e parë po bëhen vizitat sistematike. Por më në fund ka filluar diqka për së mbari dhe kjo është për të mirën e nxënësve.

Z.Feriz Gashi: për drejtorin e arsimit e kisha një kërkesë, a kish pas mundësi që prej buxhetit të komunës me u pagu roja e shkollës edhe punëtorët e sigurimit?

Z.Naser Gega: sigurishtë çështjet e arsimit i prekim çdo ditë se kemi fëmijë, kemi familjarë tonë dhe ne nuk mundem me tjetërsu situatën. Mirë kur thuhet se a kanë me pas ngrohjet fëmijet mirpo këto pyetje tjera keni punësuar këtë e atë kjo kohë ka mbaruar, kanë emra dhe mbiemra secili rast edhe pse mund të përgjigjem nuk e shoh të arsyshme. Sa i perket çështjes së ngrohjes kontrata për dru është dy vjeqare dhe ka fillu furnizimi me lëndët djegëse(dru), me naftë po, ka mbetur vetem me pelet. Me pelet kemi pak objekte të cilat ngrohen edhe ato do të tejkalohen. Sa i perket konkurseve dhe punësimit znj.Hidajete nuk e di për çka e keni fjalën mund të thuash

konkretishtë për këtë rast ose për atë rast. E tash e kam të qartë zyrtarët e drejtorisë i kam porosit që kur thirren për test , intervistë e beni thirrjen me mesazh që të mbet dokument dhe te njëri nuk kemi mundur me dokumentu që ju ka bë thirrja. Pala thotë nuk më ka thirrë, zyrtarët thonë e kanë thirrë, dhe nuk kemi mund me dokumentu që është thirrë dhe për këtë arsye është dasht me ri përserit testin. Sa i përket këshillit të prindërve absolut asnjë shkollë nuk ka nevoj me kërku pare prej prindërve për funksionalizim normal të procesit arsimor, por kemi prind është vullneti i tyre që klasen ta kenë më të bukur, më të pastërt më atraktive. Por drejtorët e shkollave e kanë repsishtë të ndaluar me kërku para, mirëpo këshilli i prindërve është në vullnetin e tyre nese ata dojnë me u vetëorganizu. Sa i perket vizitave mjeksore sigurishtë që është një raport i mirë dhe ka rezultuar shumë pozitiv. Por sigurisht që do të përfshihene dhe nxënësit e Gllogjanit dhe Baranit sepse janë edhe ata nxënësit tonë dhe e kemi obligim, dhe pajtohem me juve plotësishtë.

Znj.Hidajte Krasniqi: drejtor shumë i qartë ke vetem për diqka nuk u pajtova me juve kur the që prindërit, dikush don me bë një klasë po e marim shembull hipotetikishtë Devollët dojnë me i sjellë kauqa në klasë dhe komoditet, duhet me pas shkolla një rregullore që edhe nese don prindi jo me u dallu klasa prej atyre të pasurëve nga ata që nuk kanë! Nuk është në rregullë një klasë e gëlqerosme një jo, nese ata prind kanë vullnet le të ndihmojnë për shkollë për të gjitha gjërat qka ka nevoj shkolla në menyre të barabartë.

13.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

Nuk ka pasur

14.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Rajan Arapi: meqenëse është senaca e fundit pata dëshirë të dal dhe t'ju drejtohem secilit me një fjalim të shkurtë. Të ndëruar, z.Kurbogaj, përfaqësuesit e ekzekutivit, OSEBE-së, koleg nga pozita dhe opozita me të cilët kam pasur bashkëpunim korrekt gjatë këtyre viteve dhe mbi gjitha qytetarë të Pejës. Katër vite në këtë sallë mes jush me përgjegjësi, me nder dhe me zemer, sot mbyllet një kapitull që nuk ishte thjeshtë politik, ishte personal, ishte mision, përkushtim dhe ishte nderë të jem anëtar i kuvendit komunal të Pejës dhe të jem zëri i qytetarëve që besuan tek unë, që të luftoj për të drejten, të nevojshmit dhe për të heshturit, të përfaqësoj dinjitetin e këtij vendi pa u luhatur kurrë nga vlerat që na mbajnë. Sot mbas këtij mandati largohem me ndërgjegje të qetë. Jo pse u bë gjithqka, por se bëra gjithë që munda me guxim, me integritet me përulësi para qytetarëve të mi. Faleminderit të gjithëve, kolegeve të kuvendit pavarsishtë mospajtimeve sepse secili ka kontribuar në menyren e vetë. Faleminderit subjektiv tim që përfaqësoj me krenari PDK, kryetarit. Z.Xhavit Haliti. Faleminderit familjes sime që qëndroj pas meje, kur unë qëndroja për të tjerët. Ju faleminderit të gjithë dhe suksese kolegëve që kanë gjetur guximin të rikandidojnë.

Z.Berat Ganiqi: për piken buxhetit ne nuk murem përgjigje për pyetjet tona, rruga Doberdol – Poqestë edhe rruga e Dushkajes cfarë rruge kanë me u ndërtu dhe cka ka aty ?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kam një tezek aty te rruga e Dushkajes që 10 vjet po na bë presion me ndërtu rruga Lajqi, është kohë e gjatë e ka pas atë kërkesë dhe ju ka shty ndër vite për arsye të ndryshme. Nuk është vetem ai por ka edhe shumë blegtor atje dhe rrugen e kanë ekstrem të vëshitrë, dhe sa here ka shi ju bëhet rruga e pakalueshme.

Z.Berat Ganiqi: faleminderit u tregove transparent janë tri shpija , janë Lajq dhe rruga lidhet prej Brestovikut e deri te Maja e Zezë. A je i sigurtë qe ska dikush tjeter pronë? A po shkon rruga për tezakt e tu a për dikond tjeter?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë nuk kam tjera informata.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën **13:40 h**.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=9iZoykdTzu4>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



